



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER IRMA BROCI  
ADRESA Nr.11, Rruga "Don  
Bosko", Kulla nr.1  
TEL: 0682041600



## VERTETIM NENSHKRIMI (STATUTI)

Nr. repertori: 531  
Tirane më 23/02/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterë", i ndryshuar



V2024054320036435180

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER IRMA BROCI**



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 23.02.2024 (dymijë e njetzet e kater), para meje Noter IRMA BROCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.11, Rruga "Don Bosko", Kulla nr.1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:** Ildir Hysi, atësia Bujar, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Arkitekt Kasemi; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 08/01/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034506027 dhe nr. personal J201080670 , .


**NËNSHKRUES/IT:** Enea Sula, atësia Rifat, amësia Ludjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Arkitekt Kasemi; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë 3; 0000; Tiranë, lindur më 16/08/1998, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039287591 dhe nr. personal J80816063D , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, dokumentin hartuar prej tyre e nëshkruar ne praninë e noteres Aktin e Temelimit dhe Statut per shoqerine "EVO FASHION STYLE", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE  
IRMA BROCI**



**AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
" EVO FASHION STYLE " SHPK**

Ne baze e ne zbatim te ligjit - Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" me poshte referohet si "Ligji Per Shoqerite Tregtare",

- Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lize dhe te veprimtarise private dhe privatizimit";
- Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

**VEPRIMTARIA E SHOQERISE  
" EVO FASHION STYLE " sh.p.k.**

do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejten dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane:

- Idlir Hysi, atësia Bujar, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Arkitekt Kasemi; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 08/01/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034506027 dhe nr. personal J201080670 . .

- Enea Sula, atësia Rifat, amësia Ludjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Arkitekt Kasemi; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë 3; 0000; Tiranë, lindur më 16/08/1998, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039287591 dhe nr. personal J80816063D . .

**Neni 2**

**Emri**

Emri i shoqërisë është "EVO FASHION STYLE " sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**Neni 3**

**Selia e Shoqerise**

3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: "Tirane Rr Endri Keko nr 15 Zona Kadstrale 8170 me nr pasurie 7/760-N15 .

3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 4**

**Forma ligjore**

4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja**

5.1. Shoqëria do te ushroje aktivitetin e saj tregtar per nje periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

**Neni 6**

**Objekti i aktivitetit**

Objekti i veprimtarise se shoqerise "EVO FASHION STYLE"sh.p.k. konsiston ne :



-Import -export tregëtimi me pakice e shumicë të; konfeksioneve, të të gjitha llojeve, tregëti me shumicë dhe pakice të mallrave të ndryshëm; Import -eksport dhe tregëti me shumicë dhe pakice të ndryshme, kryesisht veshje, Elektroshteptake dhe pajisje të tjera industriale, të llojeve të ndryshme etj.

**PJESA II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

**Neni 7**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë Leke) i marrë përsiper dhe i nënshkruar nga ortakët.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuotë e cila zotërohet nga ortakët si më poshtë:

Ortakë	Kuotat e Nënshkruara	Vlera në Leke	Përqindja(%)
Idlir Hysi	1	50,000	50%
Enea Sula	1	50,000	50 %
<b>Total</b>	<b>2</b>	<b>100 000</b>	<b>100%</b>

Kapitali themeltar është vetëm në monedhën vendase leke.

**III. STRUKTURA DREJTUESE**  
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

**Neni 8**

**Përgjegjësia e kufizuar**

8.1. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

**Neni 9**

**Të drejtat e lidhura me çdo kuotë**

9.1. Çdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

**Neni 10**

**Fitimi dhe kalimi i kuotave**

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nepermjet:

- a. kontributin në kapitalin e shoqërisë,
- b. shitblerjes;
- c. trashëgimise
- d. dhurimit
- e. çdo mënyrë tjetër parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do behet me shkrim.

**Neni 11**

**Detyrimet e ortakëve**

11.1. Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

**PJESA IV**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**  
**Neni 12**

**Të drejtat e asamblesë së përgjithshme**

- 12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
  - (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
  - (g) pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
  - (h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - (i) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
  - (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
  - (l) të vendosë për investimet;
  - (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
  - (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
  - (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
  - (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
  - (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
  - (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - (t) përcaktimin e shpërblimeve për likujduesit, ekspertet kontabël;
  - (u) mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
  - (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes së asamblesë;
  - (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
  - (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
  - (y) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
  - (z) Marrjen e huave në emer të shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huase
  - (aa) Lidhjen e marrëveshjeve për dhënien e huave
- 12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

**Neni 13**

**Vendimet e asamblesë së përgjithshme**

- 13.1 Vendimet e renditura përta i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

**Neni 14**

**Thirrja e asamblesë së përgjithshme**



14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.

14.2 Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës.

14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email, telexi apo faktsi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njejtat kushte dhe afate.

14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së përgjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.

14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.

14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

#### Neni 15

##### Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme

15.1 Vendimet në asamblenë e përgjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblesë, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.

15.4 Nëse mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

#### Neni 16

##### Drejtimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme


16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme do të caktohet nga ortakët.

16.2 Do të aprovohen apo refuzohen veçem ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblesë. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

#### Neni 17

##### Procesverbali i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

17.1 Për cdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin



- tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

**PJESA V**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**  
**Neni 18**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administratore, të cilet do të përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese së Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
  - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
  - (f) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
  - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
  - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
  - (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
  - (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
  - (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;



- (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dëkta e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
  - (m) zbirjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me zbirjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
  - (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
  - (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
  - (p) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.
- 18.6 Personat e mëposhtëm do të caktohen administratorë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje:

**Administratorë do të jenen të dy ortakët të cilët mund të veprojnë së bashku ose seci me të drejtë të barabarta**

Idlir Hysi, atësia Bujar, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Arkitekt Kasemi; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 08/01/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034506027 dhe nr. personal J201080670 . .

- Enea Sula, atësia Rifat, amësia Ludjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Arkitekt Kasemi; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë 3; 0000; Tiranë, lindur më 16/08/1998, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039287591 dhe nr. personal J80816063D

## PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

### Neni 19


#### Viti financiar, pasqyra vjetore financiare

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të çdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
  - (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

### Neni 20

#### Fitimi i Shoqërisë

Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.  
Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare





të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

## PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 21 Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendimi i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## PJESA VIII TE PERGJITHSHME


### Neni 22 Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 ( tre ) kopje origjinale.

Tirane me 23 shkurt 2024

### ORTAKET

ENEASULA

*Enea Sula*  


IDLIR HYSI

*Idir Hysi*

